

VENDIM
Nr. 708, datë 12.10.2016

**PËR KRIJIMIN, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE KLASIFIKIMIN E ZONËS SË
PËRHERSHME DOGANORE TIRANË (VORË-MUÇAJ)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Krijimin e zonës së përherhme doganore Tiranë (Vorë–Muçaj), në brendësi të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Shtrirja e zonës doganore është një sipërfaqe prej 71 654 (shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) m², sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi.


3. Për zbatimin e këtij vendimi, sipas pikave 1 dhe 2, autorizohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të rinegociojë dhe të nënshkruajë kontratën e qirasë lidhur me shoqërinë “Continental Group” sh.a. Objekti i veprimtarisë, përbërja dhe funksionimi i grupit negociator të kësaj kontrate përcaktohen me urdhër të ministrit të Financave.


4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

DOGANA TIRANË (VORË-MUÇAJ)







POZICIONIMI I NDARJES SIPAS MATJEVE FAKTIKE

Pasuria nr. 146/20, Zk. 2726, vo. 10, fq. 36, me sipërfaqe totale 56358m² do të ndahet si më poshtë :

- ☐ - Sipërfaqja e kontrollit të hyrjes dhe peshorës hyrëse $S_1 = 1300m^2$
- ☐ - Zona e kontrollit fizik dhe peshorja $S_2 = 916,5m^2$
- ☐ - Sipërfaqja e magazinës së sekuestrore dhe bankinave të kontrollit $S_3 = 800m^2$
- ☐ - Sipërfaqja e godinës së administratës doganore $S_4 = 750m^2$
- ☐ - Sipërfaqja e parkingut përreth $S_5 = 2460m^2$
- ☐ - Sipërfaqja e uqelur $S_6 = 51048m^2$

Pasuria nr. 145/19, Zk. 2726, vo. 9, fq. 213, me sipërfaqe totale 6404m² do të ndahet si më poshtë :


- ☐ - Sipërfaqja e kontrollit fizik dhe peshorja vëbi të $S_1 = 480,7m^2$
- ☐ - Sipërfaqja e uqelur $S_2 = 1597m^2$

Sipërfaqja prej 390m² që përfaqëson kontrollin fizik dhe peshoren bie mbi pasurinë 517/4

POZICIONIMI NE ORTHOFOTO SH 1:2000



POZICIONIMI NE HTR E ZVRPP SH 1:2000



PERGATITI Emri: <u>BRUNELDA LAZI</u> Licenca Nr. TZ 0645/1 Datë 26/04/2016 Data e përgatitjes: 12/05/2016	IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE: 2726 NR. PASURISE: 146/20, 145/19 INDEKSI I HARTES: K-34-564198-C-D1 SHKALLA: 1:2500 ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE FJ. SHKALLA: Buj PEG: SH X Ap KODI:
---	---

